



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 619/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit KVO-së datë 05.06.2017 për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “M.B.Kurti” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-17117-06-08-2017, me objekt “*Blerje Materiale Pastrimi*” me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 27.06.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Ankimues:

“M.B.Kurti” sh.p.k
Lagjia “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iliaz Ahmeti” pranë Fabrikës së Qumshtit, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kukës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.06.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-17117-06-08-2017, me objekt “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 27.06.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

II.2 . Në datën 27.06.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 05.07.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Nazmi Dida”	pa ofertë	I skualifikuar
2. “Behar Lamaj”	pa ofertë	I skualifikuar
3. “Dimex”	pa ofertë	I skualifikuar
4. “T&M Chemical Distribution”	pa ofertë	I skualifikuar
5. “Novogen International”	pa ofertë	I skualifikuar
6. “Ë.Center”	pa ofertë	I skualifikuar
7. “Euro Mega 2010”	1.650.000 lekë	I skualifikuar
8. “M.B.Kurti”	2.100.000 lekë	I skualifikuar
9. “Mega Plast 2L”	2.248.400 lekë	kualifikuar
10. “Avni Hysa”	2.250.000 lekë	I skualifikuar
11. “Murati D”	2.273.040 lekë	kualifikuar
12. “Atlantik 3”	2.407.250 lekë	kualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik ankimues “M.B.Kurti” sh.p.k është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: “*Operatori ekonomik për periudhën Mars, Prill dhe Maj, urdhër-pagesat e paraqitura nuk i ka të vulosura nga banka. Operatori nuk ka paraqitur formularin E-Sig 025/a për muajin Maj*”.

II.4. Në datën 14.07.2017, operatori ekonomik ankimues “M.B.Kurti” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për s’kualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat se:

- *Shoqëria jonë pasi analizoi me kujdes arsyetimin e AK, konkludoi se skualifikimi është i padrejtë dhe i pabazuar. Kështu në pikën 2 tek kapaciteti teknik kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve të siguruar, minimalisht 5 (pesë) punonjës, për zbatimin e kontratës. Personat e punësuar duhet të jenë të siguruar periudhën Janar – Maj 2017. Kjo të dëshmohet me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar (Formulari E-SIG 02/a) të shoqërohet me formularët E-SIG 025/a, si dhe urdhër – pagesat e shlyerjes së detyrimeve të sigurimeve shoqërore. Sqarojmë se në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet shprehimisht se operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim mbi numrin e punonjësve për secilin prej muajve janar, shkurt, mars, prill, maj 2017. Kjo kërkesë nënkupton që numri prej 5 punonjësish (më pas i modifikuar në 4 punonjës) të jetë i siguruar midis kësaj periudhe kohore dhe jo më herët. Në përmbushje të kësaj pike kemi paraqitur vërtetim nga administrata tatimore (formulari E-Sig 025/a) për muajt janar, shkurt, mars, prill, Listpagesat e konfirmuara (formulari E-Sig 025/a) për muajt janar, shkurt, mars, prill, Listpagesën e muajit maj 2017 (e nxjerrë nga sistemi i tatimeve) si dhe urdhër-pagesat e vulosura nga banka mbi shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për muajt janar-shkurt 2017. Numri i punonjësve të shoqërisë tonë, vetëm për muajt janar-shkurt 2017 e tejkalon disa herë kërkesën e AK, qoftë kjo edhe si numër mesatar punonjësish për 5 muajt e fundit. Gjithashtu theksojmë se përsa kohë kemi paraqitur vërtetim tatimesh (për shlyerjen e sigurimeve shoqërore) të vlefshëm, i cili përcakton se subjekti ynë nuk ka detyrime deri më datë 01.06.2017, rrjedhimisht edhe urdhër – pagesat janë dorëzuar në sistem dhe paguar brënda afatit ligjorë.*

II.4.1 Në datën 17.07.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2934 prot i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.4.3. Në datën 27.07.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën nr. 3098/1 prot, datën 07.08.2017, protokolluar me tonën me nr 1335/2 prot, datë 09.08.2017, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi..

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 05.07.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.1. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, si dhe kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor ndaj operatorit ekonomik ankimues konstatohet se pranë autoritetit kontraktorë është protokolluar ankesa me nr 2924 prot, datën 14.07.2017, e operatorit ekonomik ankimues me anë të të ciliës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 17.07.2017, me shkresën nr. 2934 prot datë 17.07.2017, operatori ekonomik ankimues “M.B.Kurti” sh.p.k është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

III.1.3. Në datën 27.07.2017, operatori ekonomik “M.B.Kurti” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, “M.B.Kurti” sh.p.k, rezulton se ankesa e ankimuesit është protokolluar nga autoriteti kontraktor në datë 14.07.2017. Autoriteti kontraktor në datën 17.07.2017 me anë të shkresës nr. 2934 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese “M.B.Kurti” sh.p.k. duke vendosur refuzimin e ankesës me argumentin se ankesa është e pa bazuar në ligj dhe prova/fakte konkrete. Ndërkohë ankesa drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 27.07.2017.

Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik “ të ndryshuar strictu sensu parashikohet se “ Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar”, sipas këtij ligji.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës pasi ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit më datë 05.07.2017.

Komsioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor jashtë afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1 të L.P.P.-së. Sa më sipër, K.P.P. konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 14.07.2017 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e nesërme e punës pasi ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në tejkalim të afateve ligjore më datë 14.07.2017.

III.1.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “M.B.Kurti” shpk nuk ka respektuar afatet e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*” referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (*ndër to dhe ai i ankimit*), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.7. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: *asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit*, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Përsa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomikë “*M.B.Kurti*” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. *REF-17117-06-08-2017*, me objekt “*Blerje Materiale Pastrimi*” me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 27.06.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1335 Protokoli; Datë 27.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Hektor Balluku

Anëtar

Kleves Janku

**Kryetar
Evis Shurdha**